

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6484
E mërkurë, 8 dhjetor 2021
çmimi 0.40

Përparim Rama merr detyrën e kryetarit të Prishtinës

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ËSHTË MBAJTUR TAKIMI I KATËRT I KËSHILLIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET
KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN

FAQE 4-5

KURTI DHE BORRELLI NUK PAJTOHEN PËR ASOCIACIONIN



Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Josep Borrell, i ka kërkuar kryeministrit Albin Kurti zbatimin e marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në konferencën e përbashkët për medie, pas takimit të katërt të Këshillit të Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së, ai ka thënë se zbatimin e kësaj marrëveshjeje e ka obligim Kosova. Kurse kryeministri Albin Kurti ka vlerësuar se kjo marrëveshje është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës

Nis hartimi i planit për procesin e aplikimit në UNESCO

FAQE 6



GUCATI: DOKUMENTET KANË TREGUAR QË GJYKATA SPECIALE KA BASHKËPUNUAR ME ATË SERBE

FAQE 7

12 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

F. 3

VAZHDON RITJA E ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE NË KOSOVË

F. 7

AKTAKUZË PËR ORGANIZIM DHE PJESËMARRJE NË GRUP TERRORIST

F. 6

EKONOMI



MASAT KUFIZUESE REVOLTOJNË BIZNESET: "PO FALIMENTOJMË"

F. 8

SHALA: KOSOVA RREZIKON MILIONA EURO PËR EFIÇENCË TË ENERGJISË NGA BE-ja

F. 8

SPORT



BARCELONA KUNDËR BAYERNIT KËRKON KUALIFIKIMIN

F. 24

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bosnja arreston pesë të dyshuar për krime lufte

SARAJEVË, 7 DHJETOR - Agjencia për Hetime dhe Mbrojtje e Bosnje e Hercegovinës (SIPA) tha se pesë ish-ushtarë janë arrestuar në Sarajevë nën dyshimet se kanë kryer krime kundër civilëve serbë që ishin të burgosur gjatë luftës në Bosnjë më 1992-1994.

Përmes një deklarate, SIPA tha më 7 dhjetor se të paktën tetë civilë ishin vrarë dhe mbi 100 të tjerë ishin plagosur nga pesë ushtarët që po akuzohen për burgosje të paligjshme, torturë, abuzim, punë të detyrueshme, keqtrajtim fizik dhe mendor, si dhe vrasje.

Civilët e burgosur ishin mbajtur ilegalisht gjatë periudhës së luftës në kampe të të burgosurve, që

gjendeshin në objektin e një shkolle dhe në një ndërtesë të papërfunduar në Sarajevë. "Të pandehurit akuzohen për vrasjen e të paktën tetë civilëve të cilët kishin qenë të burgosur. Në mesin e të dyshuarve ka edhe keqbërës të cilët kanë qenë të përfshirë në vrasje", u tha në deklaratë. SIPA tha, po ashtu, se policia serbe ishte pjesë e operacioneve teksa disa nga viktimat tani jetojnë në Serbi. Mbi 100 000 persona u vranë gjatë konfliktit në Bosnje, që përfundoi pas arritjes së një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara, që ndau administratën e shtetit në linja etnike në mesin e boshnjakëve, serbëve dhe

kroatëve.

Ky është operacioni i tretë në dy javët e fundit për arrestimin e të dyshuarve për krime të luftës.

Më 3 dhjetor shtatë persona u arrestuan dhe u akuzuan për pjesëmarrje në vrasjen e 22 boshnjakëve, përfshirë edhe shtatë fëmijë, në fshatin Balatun. Vrasjet në këtë fshat kishin ndodhur pothuajse 30 vjet më parë. Atëbotë, tre persona të dyshuar për këto vrasje ishin anëtarë të policisë serbe.

Katër ditë para kësaj, Agjencia tha se ka arrestuar nëntë persona në qytetin Novi Grad nën dyshimet për krime kundër njerëzimit. Mbi 100 000 persona vdiqën gjatë luftës në Bosnje.



Serbët e Bosnjës gjatë konfliktit e kishin rrethuar kryeqytetin, Sarajevën, por shumë serbë vazhduan të qëndronin në qytet dhe dhjetëra u vranë nga luftëtarët boshnjakë që ishin në Sarajevë.

Raportet etnike në Bosnje vazhdojnë të jenë të tensionuara edhe pasi marrëveshja e vitit 1995 i dha fund konfliktit dhe krijoi dy entitete brenda Bosnjës - një entitet të serbëve të Bonjës dhe kroatëve të Bonjës.

Malala i bën thirrje ShBA-së ta rrisë mbështetjen për vajzat dhe gratë afgane



Uashington, 7 dhjetor - Avokuesja për të drejtat e njeriut, njëherësh laureatja e Çmimit Nobel për Paqe, Malala Yousafzai, u bëri thirrje Shteteve të Bashkuara që ta rrisin mbështetjen për vajzat dhe gratë afgane. "Momentalisht, Afganistani është shteti i vetëm ku vajzat nuk kanë qasje në arsimin e mesëm. Atyre u është ndaluar që të mësojnë", ka thënë 24-vjeçarja Yousafzai në Uashington teksa po qëndronte përkrah Sekretarit amerikan të Shtetit, Antony

Blinken. "Kam punuar së bashku me vajzat afgane dhe gratë aktiviste dhe ky është mesazhi i vetëm i tyre: se atyre duhet t'u jepet e drejta për të punuar. Ato duhet të jenë në gjendje që të shkojnë në shkollë", ka pohuar ajo, duke shtuar se ky është mesazhi që kanë vajzat afgane tani. Sipas Yousafzai, kjo vajzë ka shkruar në letrën e saj, se "sa më shumë që shkollat dhe universitetet do të qëndrojnë të mbyllura për vajzat, aq më shumë do të zbehet shpresa për të ardhmen e tyre".

Ministrat e BE-së, në mbrojtje të punëtorëve të paguar pak

BRUKSEL, 7 DHJETOR - Ministrat evropianë të Punës janë pajtuar rreth masave që do ta mbrojnë nivelin e pagave në Evropë dhe u japin punëtorëve më shumë të drejta për t'i kundërshtuar pagat e ulëta.

Ndonëse propozimet nuk përcaktojnë pagën minimale në nivel të Bashkimit Evropian, në momentin kur ligji hyn në fuqi, do të paraqesë hap të rëndësishëm në promovimin e modelit social evropian, sidomos në shtetet e Evropës Lindore ku pagat janë të ulëta.

Shtetet anëtare të BE-së historikisht ishin të ndara rreth kësaj çështjeje sepse sistemi kombëtar i pagës dhe paga minimale dallojnë nga shteti në shtet, nga 312 euro në muaj në Bullgari dhe 2 142 euro në Luksemburg, bazuar në të dhënat e publikuara vitin e shkuar.

Disa shtete nordike posaçërisht janë kundër çfarëdo ndryshimi në sistemin e pagave meqë kompanitë negociojnë pagën direkte me sindikatat, pa ndërhyrjen e shtetit. "Puna duhet të paguhet. Nuk mund



të pranojmë që njerëzit të cilët japin gjithë energjinë e tyre për punë të jetojnë në varfëri dhe nuk mund t'i

ofrojnë vetes standard të dinjitetshëm të jetesës", tha Janez Cigler Kral, ministër sllloven i Punës.

Kështu shtetet e BE-së me sistemin e pagës minimale detyrohen të garantojnë që niveli i pagës të përditësohet në mënyrë të rregullt e të drejtë. Një burim nga Bashkimi Evropian tha se kompromisi i arritur është i brishtë dhe negociatorët do të jenë nën presion të mos i japin Parlamentit Evropian bazë për miratimin e këtij ligji. Franca merr presidencën e BE-së nga 1 janari derisa dakordimi mes shteteve anëtare për nivelizim të pagave do të jetë prioritet i mandatit të saj gjashtëmuajsh.

12 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se janë regjistruar edhe tetë raste të reja me koronavirus. Rastet e reja dolën pas testimit të 2 274 mostrave. Sipas raportit, në 24 orët paraprake janë shëruar edhe 12 pacientë.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në Kosovë aktualisht janë 314 raste aktive me koronavirus. Sa i përket

vaksinimit, brenda 24 orëve janë dhënë 4 019 vakcina kundër koronavirusit. Që nga fillimi i fushatës së vaksinimit në Kosovë në mars, në gjithë vendin janë dhënë 1 630 082 doza të vaksinës.

Deri të martën, më 7 dhjetor, të dyja dozat e vaksinës i kanë marrë 768 564 qytetarë apo mbi 42 për qind e popullsisë.

Në Kosovë të drejtë vaksinimi

kanë të gjithë personat mbi 12 vjeç. Ata mund të zgjedhin një prej vaksinave që janë në përdorim në Kosovë: vaksinën "Pfizer/BioNTech" ose "AstraZeneca".

Situata epidemiologjike në Kosovë është vlerësuar se është e qetë, për dallim nga rajoni dhe Evropa që aktualisht po përballen me një valë të re të infeksioneve.



Nis hartimi i planit për procesin e aplikimit në UNESCO

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës të drejtuar nga kryetari Ardian Gola, në të cilën ka raportuar ministri për Kulturë Rini dhe Sport (MKRS), Hajrullah Çeku.

Gjatë raportimit të tij ministri Çeku ka njoftuar se është duke u hartuar plani zbatues për procesin e aplikimit dhe anëtarësimin të Kosovës në UNESCO. Ai, po ashtu, ka bërë me dije se për herë të parë është bërë studimi profesional i vlerësimit të gjendjes fizike të ndërtesave brenda Kompleksit "Adem Jashari" në Prekaz. "Janë hartuar projektet e ndërhyrjeve emergjente dhe pritet që punimet të fillojnë së shpejti. Është themeluar edhe komisioni i ekspertëve, si trup profesional i komitetit, ndërsa gjatë pjesës së parë të vitit të ardhshëm, në bazë të rekomandimeve të komisionit të ekspertëve, do ta marrim vendimin për hapat e master-planit për Kompleksin Memorial "Adem Jashari", ka thënë Çeku.

Më tutje, ai ka theksuar se është themeluar komisioni shtetëror



për dokumentimin e shkatërrimit të trashëgimisë kulturore gjatë luftës së vitit '98-99.

Çeku ka shtuar se do ta kërkojnë kthimin e artefakteve nga muzeu i Beogradit.

MKRS-ja, ka thënë ai, ka

planifikuar një milion euro buxhet për ndërhyrje emergjente në monumente. Krahas kësaj, Çeku ka njoftuar edhe për vlerësimin e monumenteve në terren e që, sipas tij, janë 200 prej tyre, të identifikuara në gjendje të rëndë. Ndërkaq edhe gjatë

vitit 2022, sipas tij, do të vazhdojnë ndërhyrjet në monumentet që janë në rrezik. Anëtarët e komisionit i kanë bërë pyetje ministrit dhe kanë ngritur çështje që kishin të bënin me: krijimin e një muzeu shkencor, statutet e operës,

Ligjin për kinematografinë, për largimin nga buxheti të Muzeut të Paqes, situatën lidhur me "Hamamin e Prishtinës" etj. Ministri e Çeku u është përgjigjur pyetjeve të deputetëve, duke dhënë sqarime të nevojshme.

Refuzohet kërkesa e Avokatit të Popullit për buxhet shtesë

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, kryesuar nga kryetari Armend Muja, ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës. Në këtë mbledhje është shqyrtuar Projektligji nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Me propozim të kryetarit Muja, komisioni ka shqyrtuar një nga një kërkesat e institucioneve për mjete shtesë buxhetore.

Kryesuesi i grupit punues që ka shqyrtuar këto kërkesa, deputeti Eman Rrahmani, i ka lexuar

kërkesat e institucioneve qeveritare dhe ka paraqitur rekomandimet e grupit. Grupi punues ka rekomanduar refuzimin e kërkesës së specializantëve të mjekësisë për paga dhe mëditje, i cili është përkrahur nga shumica e anëtarëve të Komisionit. Po ky komision me shumicë votash ka refuzuar kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit për buxhet shtesë, po ashtu edhe kërkesën e KOSTT-it për mbulimin e shpenzimeve për rrymë.

Me shumicë votash komisioni

ka refuzuar kërkesën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për rritjen e buxhetit për këtë institucion.

Komisioni për Buxhet dhe Transfere ka mbështetur rekomandimin e grupit punues që të refuzojë dy kërkesa të ARKEP-it për rritjen e buxhetit për paga dhe mëditje.

Po ashtu, komisioni me rekomandim të grupit punues ka vendosur që të mos aprovohen kërkesat e 31 komunave për ndarje të buxhetit shtesë.

Po me rekomandim të grupit punues, komisioni me shumicë



votash ka miratuar kërkesën e Agjencisë për Informim dhe Privatësi për buxhet shtesë, të

Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe pjesërisht të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".



ËSHTË MBAJTUR TAKIMI I KATËRT I KËSHILLIT TË STABILIZIM ASOCIIM
NDËRMJET KOSOVËS DHE BASHKIMIT EVROPIAN

Kurti dhe Borrelli nuk pajtohen për asociacionin

Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Josep Borrell, i ka kërkuar kryeministrit Albin Kurti zbatimin e marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në konferencën e përbashkët për medie mbajtur pas takimit të katërt të Këshillit të Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së, ai ka thënë se zbatimin e kësaj marrëveshjeje e ka obligim Kosova, kurse kryeministri Albin Kurti ka vlerësuar se kjo marrëveshje është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk është pajtuar të martën me përfaqësuesin e lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Josep Borrell, për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në një konferencë të përbashkët për media në Bruksel, Kurti ka thënë se kjo marrëveshje është në kundërshtim me Kushtetutën, ndërsa kryediplomati evropian ka thënë se marrëveshja duhet të zbatohet. "Janë 33 marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë, dhe dy të

tretat e tyre s'janë zbatuar nga Serbia, por gjithmonë Beogradi zyrtar dëshiron ta përmendë një marrëveshje që më duhet ta them s'e ka kaluar testin e Gjykatës sonë Kushtetuese. Më kujtohet më 2015, kur në vendimin e saj asnjë serb i Kosovës nuk protestoi, por vetëm Beogradi. Besoj se është koha që të ketë dialog, ku populli, qytetarët, janë përfituesit e jo politikanët. Prandaj na duhet karakter demokratik i dialogut që të fitojnë njerëzit. E rrithekoj se në fund të dhjetorit të 2015 serbët nuk u bregosën fort për vendimin e Kushtetueses, por ishte Beogradi që po vajtonte për atë që ka ndodhur", ka thënë

Kurti. Sipas Kurtit, themelimi i këtij asociacioni i shkon përshtati vetëm Beogradit. "Të gjitha zgjidhjet që vijnë nga lart për t'i kënaqur politikanët e caktuar s'janë demokratike e unë jam demokrat dhe besoj se kapitujt e ardhshëm në mes të Kosovës dhe Serbisë s'duhet të jenë për ta shpëtuar lëkurën e një politikani, por t'i shërbejnë popullit dhe kam frikë se ky Asociacion është në shërbim të Beogradit shumë më shumë sesa ndonjë qytetari serb të Kosovës të

cilëve u shërbej po aq si kryeministër i kësaj republike", ka deklaruar Kurti. Me qëndrimin e Kurtit nuk është pajtuar përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Josep Borrell. Shefi i diplomacisë evropiane ka kërkuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht prej vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. "Pajtohem që Gjykata Kushtetuese (e Kosovës) vendosi pengesa për

zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Por, kjo (marrëveshje) u arrit ndërmjet përfaqësuesve të dy qeverive dhe në kuadër të dialogut. Kështu që, më vjen keq, por na duhet ta kërkojmë zbatimin e kësaj marrëveshjeje", ka thënë Borrell.

Kryediplomati evropian ka deklaruar se procesi i dialogut është i vetmi forum për zgjidhjen e çështjeve mes të dy vendeve. "Më lejoni të them se edhe unë jam

Sivjet s'pritet të ketë takim tjetër Kurti - Vuçiq

Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka shprehur skepticizëm se një takim i ardhshëm në dialog në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të mbahet në dhjetor. Pas mbledhjes së katërt të Këshillit të Stabilizim Asociimit në Bruksel, Borrelli

ka thënë se s'ka parë gatishmëri nga palët për një takim të ardhshëm. "Ne gjithmonë organizojmë takime dhe mbledhje kur është e përshtatshme. S'kemi njoftuar ende. E kemi bërë të qartë që pas dy takimeve sivjet, parakusht është gatishmëria e të dyja palëve të pajtohen për rezultate konkrete. Do të ishte e

pakuptimtë të mbajmë takim nëse kushtet s'përbushen e të takohemi prapë për asgjë. Në bazë të informatave që kam marrë edhe nga emisari i posaçëm dhe nga puna e tij e palodhshme, s'ka gatishmëri në këtë pikë. Por ende s'ka përfunduar dhe do të bëjmë gjithçka që mundemi që të kemi takime të tilla", ka thënë Borrelli.

KQZ-ja pranon 137 pako të supozuara me fletëvotime nga diaspora për Dragashin

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nga 29 nëntori e deri tani ka pranuar 137 pako të supozuara me fletëvotime me postë nga votuesit e regjistruar nga jashtë Kosovës për përsëritjen e votimit për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale në komunën e Dragashit. Kështu ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Burim Ahmetaj, i cili ka treguar se kanë zhvilluar të gjitha aktivitetet për informim të të

gjithë votueseve me të drejtë vote. "Sekretariati është në përgatitje për përsëritjen e raundit të dytë në komunën e Dragashit për procesin e votimit jashtë vendit, periudhë që ka filluar nga data 29 nëntor deri më 13 dhjetor 2021, dhe ka zhvilluar të gjitha aktivitetet për informim të të gjithë votuesve me të drejtë vote dhe ka marrë hapat për të informuar përmes proceseve të informimeve publik. Deri më tani, 6 dhjetor, sekretariati ka pranuar 137 pako të supozuara

me fletëvotime përmes postës", ka thënë Ahmetaj.

Anëtari i KQZ-së nga radhët e LDK-së, Florian Dushi, ka ngritur si shqetësim rrjedhjen e listës me numrat e telefonave të personave të regjistruar për votim nga jashtë. Në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është miratuar edhe zëvendësimi i anëtarëve të kuvendeve komunale në Lipjan, Suharekë, Graçanicë, Ferizaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, Partesh dhe Pejë.



S'ka buxhet për paga dhe mëditje për 600 specialistë të mjekësisë

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka refuzuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për mbulimin e pagave dhe mëditjeve të 600 specialistëve të

mjekësisë, me arsyetimin se mundësitë buxhetore nuk ekzistojnë. Kryesuesi i grupit punues për buxhetin 2022, deputeti nga LV-ja, Eman Rrahmani, ka thënë se është e pamundur që

specializantët e mjekësisë të hyjnë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve pasi, siç ka thënë ai, tavanet buxhetore nuk mund ta lejojnë një gjë të tillë. "Arsyeja e refuzimit të

kërkesës të specialistëve është për shkak edhe të një diskutimi të përbashkët me Ministrinë e Financave, mundësitë buxhetore nuk ekzistojnë, janë tavanet buxhetore të cilat nuk e

përballojnë një numër kaq të madh prej 600 specialistëve. Kërkesa e tyre është që të hyjnë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve", ka thënë Rrahmani.



demokrat dhe nuk jam këtu për ta shërbyer cilindo politikan nga cilado anë. Ajo çfarë ka ndodhur me tabelat e veturave ka dëshmuar se dialogu është i vetmi forum për t'i zgjidhur të gjitha çështjet e hapura. Do të doja që ju ta merrni parasysh rëndësinë e këtij dialogu për t'i tejkaluar vështirësitë për Kosovën për integrim të plotë në bashkësinë

ndërkombëtare", ka deklaruar Borrelli.

Kurti takon komisionarin për Zgjerim të BE-së, Oliver Varhelyi

Kryeministri Albin Kurti gjatë vizitës në Bruksel është takuar edhe me komisionarin për Zgjerim dhe Fqinjësi të Bashkimit Evropian, Oliver

Varhelyi. Sipas njoftimit të qeverisë, në këtë takim është biseduar mbi marrëdhënien ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian në kontekstin e marrëveshjes kontraktuale të Stabilizim-Asociimit, si pjesë e procesit të integritimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, me theks tek angazhimi i vazhdueshëm dhe progresi që Kosova ka

bërë për reformën në drejtësi dhe luftën kundër krimit të organizuar.

Kurti ka vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të Komisionit Evropian për reforma dhe ka përsëritur kërkesën që shtetet anëtare brenda Këshillit të BE-së të marrin vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. Në takimin që i ka

paraprirë mbledhjes së katërt të Këshillit të Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës kanë qenë të pranishëm edhe zëvendëskryeministrja, njëherësh ministre e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, si dhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Bruksel, Astrit Zemaj.

Nura: Objektivi ynë kryesor është rritja e kualitetit në procesin mësimor

Skenderaj, 7 dhjetor (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka takuar të martën drejtorët e shkollave, me qëllim të diskutimit rreth procesit edukativo-arsimor. Ai ka thënë se si komune kanë

synim ngritjen e cilësisë në mësimnxënie dhe mësimdhënie. “Në kuadër të kësaj do ta zbatojmë planin e decentralizimit në shkolla, ku drejtoritë do të kenë autonomi të plotë financiare, për nevojat dhe

qëllimet e tyre profesionale. Objektivi ynë kryesor është rritja e kualitetit në procesin mësimor, për të ardhmen e fëmijëve dhe nxënësve tanë”, ka thënë kryetari Nura.



Përparim Rama merr detyrën e kryetarit të Prishtinës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Kryetari i ri i Prishtinës, Përparim Rama, ka pranuar të martën edhe zyrtarisht detyrën e të parit të kryeqytetit. Rama ka dhënë betimin para anëtarëve të asamblesë komunale të Prishtinës. “Unë Përparim Rama betohem se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushroj kompetencat si kryetar i Prishtinës me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme që të sigurojë kushte për një jetë të qetë për të gjithë”, ka thënë Rama.

Ai ka shtuar se sot është ditë e veçantë për qytetarët e Prishtinës dhe se nga sot zëri i tyre nuk është moto e fushatës, por zotim i tij dhe i ekipit. “Besimi i qytetarëve më jep përgjegjësi të jashtëzakonshme. Jam i vetëdijshëm që kjo detyrë përtej privilegjit është obligim

serioz dhe sfidë e madhe që do t'i vihemi përpara me punë të ndershme, me profesionalizëm dhe me dinjitet”, ka deklaruar Rama.

Rama ka theksuar se ndihet mirënjohës për të gjithë qytetarët e Prishtinës në çdo lagje e fshat. “Guximi me ia dashtë të mirën vendit tonë, të mos ndalet këtu. Forca e unitetit, sinçeritetit e bashkimit na duhet për të çuar përpara këtë qytet”, u shpreh kryetari i ri i Prishtinës.

Rama ka shtuar se Prishtina do të jetë vend plot gjallëri e mundësi për të rinjtë. “Të nderuar asamblistë, si kryetar i Prishtinës do të bashkëpunoj me secilin prej jush për të mirën e kryeqytetit. I mirëpres të gjithë pa dallime për të çuar përpara projekte që përmirësojnë jetën e të gjithëve”, ka thënë Rama.

Kryetari i ri i Prishtinës i bëri ftesë shoqërisë civile dhe partive politike që t'i



bashkëngjiten në qeverisjen e tij për Prishtinën.

Detyra e të parit të Prishtinës, Ramës, iu dorëzua nga ish-

kryetari i kryeqytetit, Shpend Ahmeti, i cili mori pjesë edhe në ceremoninë e betimit të Ramës dhe asamblistëve. Prej

51 asamblistëve të zgjedhur, në seancë morën pjesë 48. Munguan Arben Vitia, Daut Haradinaj dhe Rinë Limani.

Komuna e Mitrovicës pranon donacion një veturë të re



MITROVICË, 7 DHJETOR (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim përfaqësues nga organizata Danish Refugee Council (DRC), Anna Radchenko, menaxhere e projektit në DRC - Mitrovicë, Agron Deda, zyrtar i projektit në DRC si dhe Armend Baftiu, udhëheqës i zyrës së Prokurimit

në DRC. Qëllimi i këtij takimi ishte dorëzim-pranimi i një veture të re, donacion ky i ardhur nga organizata Danish Refugee Council (DRC), veturë kjo e cila do të shërbejë për nevojat e komunës së Mitrovicës për ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Me këtë rast, kryetari i komunës, Bedri Hamza, ka falënderuar

për bashkëpunim organizatën DRC, si dhe taksapaguesit e vendeve të donatorëve, të cilët me taksat e tyre po kontribuojnë në zhvillimin e komunës. Po gjatë takimit kryetari Hamza dhe përfaqësuesit e DRC-së biseduan edhe për projekte të tjera të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve.

Aktakuzë për organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur sot aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, kundër të pandehurit me inicialet K. D. Prokuroria Speciale njofton opinionin publik se i pandehuri i lartcekur me dashje ka marrë pjesë në veprimtarinë e

organizatës terroriste, në atë mënyrë që me bashkëshorten u është bashkëngjitur luftëtarëve të organizatës terroriste, militante, ekstremiste “ISIS” (Islamic State of Iraq and the Sham), duke marrë pjesë aktivisht në veprimtaritë e kësaj organizate si trajner i snajperistëve. Më pas i pandehuri K. D. është

arrestuar dhe është burgosur nga Forcat Demokratike Siriane, kurse më datë 17 korrik 2021, në mënyrë të organizuar, është transferuar në Kosovë. Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist” nga neni 143, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.



Vazhdon rritja e çmimeve të prodhimeve në Kosovë

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Në Kosovë, në tremujorin e dytë të vitit 2021, çmimet e prodhimit janë shtrenjtuar për rreth 6.9 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që u publikuan në muajin dhjetor, thuhet se ngritja më e madhe e çmimeve vërehet tek energjia elektrike, gazi dhe furnizimet me ajër të kondicionuar me 17 për qind,

prodhimi i metaleve me rreth 12 për qind, prodhimi i mobileve me 9 për qind dhe prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike me 4.7 për qind rritje.

Përveç rritjes së çmimeve të prodhimit, Agjencia e Statistikave njoftoi në muajin tetor për një ngritje prej 5.7-përqindësh të çmimeve të konsumit. Ngritja më e lartë e çmimeve u shënuar te buka, drithërat, mishi, qumështi, djathi, vaji, vezët, pemët dhe

perimet.

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës dhe ekspertë për çështje ekonomike kanë thënë se shumica e artikujve që janë shtrenjtuar janë prodhime që importohen nga shtetet e rajonit dhe të Evropës. Ndërkohë, disa nga vendet e rajonit dhe të Evropës janë duke u përballur me fatura shumë më të larta të energjisë për shkak të rritjes të çmimeve të energjisë elektrike dhe gazit.



Gucati: Dokumentet kanë treguar që Gjykata Speciale ka bashkëpunuar me atë serbe

HAGË, 7 DHJETOR - Ish-kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Guçati, ka vazhduar edhe të martën dëshminë e tij në Dhomat e Specializuara në Hagë, ku ka thënë se qëllimi i paraqitjes së dokumenteve që dyshohet të kenë rrjedhur nga Specialja në OVLUÇK ka qenë ta tregojë bashkëpunimin e gjykatës me autoritetet serbe.

Guçati, i cili është një prej të akuzuarve në këtë rast, ka thënë

se në dokumente ka pasur emra e deklarata të dëshmitarëve, por që OVLUÇK-ja nuk ka qenë e interesuar t'i lexojë apo publikojë ato.

Hysni Guçati po përgjigjet për të dytën ditë me radhë në pyetjet e prokurores Valeria Bolici, së cilës i ka thënë se është për keqardhje që kjo gjykatë e cila është themeluar nga Kosova të bashkëpunojë me kriminelët serbë. "Kjo është një befasi dhe është keqardhje për ne kur një

gjykatë e Kosovës, këtë gjykatë e ka votuar parlamenti dhe kjo gjykatë bashkëpunon me kriminelët serbë, është një befasi dhe keqardhje shumë", ka thënë Guçati.

Ai ka theksuar se ka parë që kishte dokumente në gjuhën serbe por, sipas tij, numrat e protokollit në ato dokumente i ka parë pasi të njëjtat kanë dalë në media. "Kam parë deklarata të dëshmitarëve serbë. Kam parë që keni marrë udhëzime nga

Drecuni, nga Vukçeviçi. Këto kanë qenë deklaratat e prokuroreve serbë që keni marrë ju, kështu kanë qenë, dhe kanë qenë disa takime që ish-prokurori i Gjykatës Speciale ka pasur me prokuroret serbë. Kështu kanë qenë disa deklarata të tyre. Këto i kam parë...", ka thënë Guçati.

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës një ditë më parë ka hedhur poshtë

pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) ndaj tij. Në dëshminë e tij para trupit gjykues të Dhomave të Specializuara në Hagë, Guçati ka fajësuar ZPS-në për nxjerrjen e dokumenteve në publik. Sipas tij, me këto veprime ata e kanë vënë në kurth atë dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së. Në adresimin e tij, Guçati ka thënë do të rridhte ndonjë dokument nga zyra e tij në OVLUÇK.



Policia kontrollon transportin publik

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Njësisia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Gjakovë është duke zbatuar plane të ndryshme operative në ngritjen e sigurisë rrugore edhe gjatë sezonit dimëror. Në vazhdim të planeve të tjera të operimit në ngritjen e sigurisë rrugore, nga data 1 dhjetor NJRKRR-ja ka filluar implementim edhe të planit operativ "Kontrollimi

i shtuar i transportit publik". Që nga fillimi i planit Njësisia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Gjakovë po vazhdon aktivitetet vetëdijesuese dhe të asaj ndëshkuese ndaj kundërvajtësve të ndryshëm. "Nga data 01.12.2021 deri më datën 05.12.2021 janë shqiptuar nga DRP-Gjakovë: 729 gjopa të ndryshme të

shkeljes së rregullave të trafikut, ku prej tyre janë shqiptuar 52 gjopa të planit operativ 'Kontrollimi i shtuar i transportit publik'. DRP Gjakovë do t'i vazhdojë aktivitetet e ndryshme në aspektin e ngritjes së sigurisë rrugore, me qëllim të parandalimit të aksidenteve rrugore", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Masat kufizuese revoltojnë bizneset: “Po falimentojmë”



PRISHTINË, 7 DHJETOR - Salla e ahengjeve “Golden Imperial” në Prishtinë po përballet me falimentim si pasojë e masave të ndërmarra për frenimin e pandemisë së koronavirusit.

Pronari i këtij biznesi, Driton Hoti, thotë se e ka të pamundur ta vazhdojë punën. Masa kufizuese Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë qysh në pranverë të vitit 2020, kur edhe ka shpërthyer pandemia. “Për 18 muaj ne kemi punuar vetëm dy muaj gjatë verës së këtij viti”, ka thënë Hoti i cili i ka të punësuar rreth 30 punëtorë.

Ai thotë se humbjet i ka të mëdha, por nuk jep ndonjë shifër të saktë. “Shifra nuk mund të jap por, në bazë të qarkullimit që kam pasur në vitin 2019, atëherë ka qenë 400 mijë euro, tani nuk kemi fare... vetëm ata dy muaj që kemi punuar”, thotë Hoti për “Radion Evropa e Lirë”. Me masat e Qeverisë së Kosovës, të ndërmarra më 30 gusht, është ndaluar organizimi i ahengjeve dhe dasmave. Në atë kohë

Kosova ka regjistruar mbi 1 000 raste të reja me koronavirus në ditë dhe dhjetëra viktime.

Puna e klubeve të natës dhe ahengjet vazhdojnë të jenë të ndaluara edhe me masat e fundit të qeverisë që kanë hyrë në fuqi më 6 dhjetor. Hoti thotë se nuk pajtohet me këtë vendim tani kur situata me koronavirus është e qetë. “Në muajin gusht, kur na mbyllën, ne jemi pajtuar që të mbyllemi për shkak të rasteve të shumta me koronavirus, por me shpresën se [kur] të stabilizohet situata dhe të vaksinohet një përqindje e madhe e qytetarëve, do të na lejohet puna”, thotë ai.

Kosova, sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, ka situatë më të qetë epidemiologjike. Nga data 1 deri më 6 dhjetor autoritetet shëndetësore kanë regjistruar 48 raste të të infektuarve me koronavirus dhe një viktimë.

Numri i rasteve aktive të hënën ka qenë 322.

Me masat e fundit kufizuese, veç

të tjerash, ashpërsohen edhe kushtet për hyrje në Kosovë, ndërsa kufizimi i lëvizjes vazhdon të jetë në fuqi nga mesnata deri në orën 05:00. Orari i punës së gastronomisë, po ashtu, nuk ndryshon; puna e këtij sektori lejohet deri në orën 23:00, ndërsa muzika ndalohet pas orës 21:30. Arian Vranica, nga Shoqata e Gastronomëve e Kosovës, e cila përfaqëson mbi 500 biznese, thotë se qeveria është dashur të marrë masa në përputhje me situatën epidemiologjike.

Nëse tani e disa muaj, Kosova po shënon numër të vogël të rasteve, thotë Vranica, qeveria është dashur të mendojë edhe për “shëndetin e ekonomisë”. “Nuk ka pasur vullnet të qeverisë për ta menaxhuar shëndetin e ekonomisë. Këto masa kanë krijuar një revoltë të madhe, sidomos të klubeve të natës dhe sallave të dasmave dhe estradës. Po ballafaqohemi me probleme të rënda. Shumë biznese janë duke falimentuar”,

thotë ai.

Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, për gati dy vjet pandemi, janë shuar mbi 2 600 biznese.

Për t'i përballuar pasojat e pandemisë, Qeveria e Kosovës ka miratuar Pakon e Ringjalljes Ekonomike, në vlerë prej 420 milionë eurosh. Në kuadër të kësaj pakoje bizneset janë ndihmuar kohë pas kohe.

Vendimin e Qeverisë së Kosovës për masat kufizuese e kundërshtojnë edhe në Odën e Hotelierisë dhe Turizmit.

Hysen Sogojeva, i cili përfaqëson mbi 300 biznese në fushën e hotelierisë dhe turizmit në Kosovë, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se kanë pritur lehtësim të masave. “Këto masa nuk janë në harmoni me bizneset. Ne, si Odë, kemi kërkuar që bizneset e sektorit të gastronomisë, hotelierisë, turizmit, të punojnë me 30 deri në 50 për qind të kapaciteteve.

Pastaj u kemi thënë se e marrim vetë obligim që asnjë person të mos hyjë në ato salla pa pasur dy vaksina [kundër koronavirusit] dhe testin [negativ] PCR”, thotë Sogojeva. Sipas tij, çdo masë që ndalon punën e bizneseve është humbje. Nëse vazhdohet me masa të tilla, deri në 35 për qind e bizneseve në këtë sektor do të falimentojnë, thotë ai.

Pavarësisht prej situatës së qetë epidemiologjike, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se masat po merren për shkak të rrezikut nga varianti i ri i koronavirusit, “Omicron”.

Ky variant është identifikuar për herë të parë muajin e kaluar, në Afrikën e Jugut, dhe është kategorizuar si shqetësues nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Në përpjekje për ta parandaluar përhapjen, disa vende i kanë kufizuar udhëtimet me vendin afrikan.

Duke folur të dielën, Kurti ka thënë se janë disa rreziqe me të cilat Kosova mund të përballet shumë shpejt. “Ardhja e mërgatës për festat e fundvitit, situata e rëndë epidemiologjike në shtetet nga vjen numri më i madh i mërgatës, shkalla e ulët e vaksinimit me të dyja dozat në Kosovë dhe shfaqja e variantit të ri të koronavirusit, i njohur si varianti ‘Omicron’, e që është më lehtë i transmetueshëm sesa varianti ‘Delta’”, ka thënë Kurti. Derisa shkencëtarët vazhdojnë t'i studiojnë efektet që mund t'i shkaktojë “Omicroni”, zyrtarët shëndetësorë në Kosovë u bëjnë thirrje qytetarëve që të vaksinohen.

Në Kosovë shkalla e vaksinimit të plotë kundër koronavirusit aktualisht është mbi 42 për qind. Sipas profesionistëve shëndetësorë, një vend duhet të vaksinohet mbi 85 për qind të popullatës, për ta pasur situatën nën kontroll.

Shala: Kosova rrezikon miliona euro për efijencë të energjisë nga BE-ja

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti nga radhët e PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se Kosova rrezikon të humbë miliona euro për efijencë të energjisë nga Bashkimi Evropian (BE). Ai ka thënë se raporti mbi masat e Planit Kombëtar të Veprimit për Efijencë të Energjisë (PKVEE) vazhdon të qëndrojë në zyrën e ministres Artane Rizvanolli. Shala në llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se Kosova ende nuk ka raportuar për progresin e arritur në Planin Kombëtar të Veprimit

të Energjisë për periudhën 2019-2021. “Bazuar në Ligjin nr. 06/L-079 për efijencë të energjisë, neni 5. Në baza vjetore, deri më 30 qershor të çdo viti, Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë (AKEE) përgatit raportin e progresit mbi përparimin në raportimin e caqeve vjetore të efijencës së energjisë, në pajtim me aktin nënligjor të përcaktuar në paragrafin 1.13 të nenit 42 të këtij ligji. Platforma e monitorimit dhe verifikimit (PMV) do të përdoret kur është e mundur, në llogaritjen e kursimeve të energjisë dhe

raportimin mbi masat e Planit Kombëtar të Veprimit për Efijencë të Energjisë (PKVEE). Raporti i dorëzohet Qeverisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Edhe pse është hartuar raporti për më shumë se tre muaj, ai ende vazhdon të qëndrojë në zyrë të ministres Rizvanolli. Ky dokument është hartuar nga donatori, ku edhe përballë donatorit që ka hartuar dokumentin ministrja del të jetë e papërgjegjshme. Raportimi është obligim për Kosovën si palë kontraktuale e Traktatit të Komunitetit të



Energjisë dhe obligim ligjor. Tani Kosova ka karton të kuq nga Traktati i Komunitetit të Energjisë për mosraportim. Nga mosraportimi, Kosova rrezikon miliona euro për

efijencë të energjisë nga Bashkimi Evropian, gjithashtu i ndalohet edhe aplikimi në burime të ndryshme financiare (grante)”, ka shkruar Shala.

Pse faraonët e lashtë egjiptianë ndaluan së ndërtuari piramida?



Nga Owen JARUS

Për më shumë se 1 mijë vjet, faraonët egjiptianë ndërtuan piramida dhe shpesh varroseshin nën ose brenda tyre. Faraonët egjiptianë ndërtuan piramida midis kohës së sundimit të faraonit Xhozer (vitet 2630-2611 Para Krishtit), që ndërtoi një piramidë me shkallë në Sakara, dhe deri në kohën e mbretit Ahmos I (1550-1525 Para Krishtit), që ndërtoi piramidën e fundit mbretërore të njohur në Abidos.

Këto piramida të famshme simbolizojnë fuqinë dhe pasurinë e faraonëve, si dhe promovuan besimet e tyre fetar. Por pse egjiptianët e lashtë ndaluan ndërtimin e piramidave menjëherë pasi filloi e ashtuquajtura epokë e Mbretërisë së Re? Në Egjiptin e lashtë, ndërtimi i piramidave nisi të zbehet pas mbretërimit të faraonit Ahmos, teksa mbretërit nisën të varrosen në Luginën e Mbretërve në afërsi të kryeqytetit të lashtë egjiptian të Tebës, që ndodhej në Luksorin e sotëm.

Projekti "Theban Mapping" thekson në faqen e saj të

internetit se varri më i hershëm mbretëror i konfirmuar në Luginë u ndërtua nga Tutmosi I (1504-1492 Para Krishtit). Edhe paraardhësi i tij Amenhotep I (1525-1504 Para Krishtit), mund të ketë ndërtuar varrin e tij në Luginën e Mbretërve, megjithëse kjo është një çështje e debatueshme midis egjiptologëve.

Ndonëse nuk është plotësisht e qartë se pse faraonët nisën të heqin dorë nga ndërtimi i piramidave mbretërore. Por një faktor mund të kenë qenë shqetësimet e sigurisë. "Ka shumë teori. Por meqë piramidat nisën të plaçkiten, fshehja e varrezave mbretërore në një luginë të largët, të gdhendur në shkëmb, dhe me sa duket me shumë roje, ka luajtur një rol në këtë aspekt" - thotë Piter Der Manuelian, egjiptolog në Universitetin e Harvardit.

Sipas Manuelian edhe përpara se të hiqnin dorë nga piramidat mbretërore, ata kishin ndaluar praktikën e vendosjes së dhomës së varrimit nën piramidë. "Piramida e fundit mbretërore - ajo e Ahmosit I në Abidos, e kishte dhomën e saj të varrimit 500 metra larg në shkretëtirë", - shprehet Eidan

Dodson, egjiptolog në Universitetin e Bristolit. Një shënim historik, që mund të përmbajë të dhëna të rëndësishme, është shkruar nga një njeri i quajtur Ineni, dhe që ishte përgjegjës për ndërtimin e varrit të Tutmosi I në Luginën e Mbretërve. Ineni shkroi: "Vetëm unë mbikëqyra gërmimin e varrit shkëmbor të madhërisë së tij, që askush të mos shihte apo dëgjonte".

Ky procesverbal "sugjeron qartazi se fshehtësia ishte një element kryesor" thotë Ana Mejsi Rot, profesore e historisë së artit dhe studimeve hebraike në Universitetin e Nju Jorkut.

Vetë topografia natyrore e Luginës së Mbretërve, mund të shpjegojë pse ai vend ishte i preferuar për varret mbretërore. Ajo ka një majë të njohur tani si El-Qurn, që duket paksa si një piramidë. Ajo i ngjan shumë një piramide, dhe në një farë mënyre të gjitha varret mbretërore të ndërtuara në luginë u vendosën nën një piramidë, thotë egjiptologu Miroslav Barta,

zëvendës/ректор i Universitetit Çarls në Republikën Çeke. Për faraonët egjiptianë,

piramida ishte e rëndësishme pasi ishte një vend "ngritjeje dhe transformimi" në botën e përtejme, shkruan Mark Lehner, drejtor dhe president i "Ancient Egypt Research Associates", në librin e tij "Piramidat e plota: Zgjidhja e mistereve të lashta".

Topografia e Luksorit, qëu bë kryeqyteti i Egjiptit gjatë Mbretërisë së Re (1550-1070 Para Krishtit), mund të ketë luajtur gjithashtu një rol në heqjen dorë nga ndërtimi i piramidave. Ajo zonë është "shumë e kufizuar në hapësirë, dhe me shumë gunga" tha Dodson.

Pra kryeqyteti i lashtë mund të ketë qenë shumë i vogël dhe sfidues nga pikëpamja arkitektonike, për të shërbyer si një vendndodhje e piramidave të reja. Ndryshimet fetare që e forcuan traditën e varreve nën tokë, janë një tjetër arsye e mundshme pse egjiptianët hoqën dorë nga ndërtimi i piramidave të mëdha.

"Gjatë Mbretërisë së Re, u bë shumë popullor koncepti i udhëtimit të mbretit nëpër botën e Ulët, dhe kjo kërkonte plane të sofistikuara mbi varret të gdhendura me gurë nën tokë,

thekson Barta. Dhe varret nëntokësore të gdhendura në Luginën e Mbretërve i përshtaten shumë mirë këtij koncepti.

Ndërsa faraonët hoqën dorë nga ndërtimi i piramidave, këtë praktikë e vazhduan individët e pasur privatë. Për shembull, arkeologët zbuluan në vitin 2014 një varr 3.300 vjeçar në Abidos, që u ndërtua për një shkruer i quajtur Horemheb, dhe që kishte në hyrje një piramidë 7 metra të lartë.

Gjatë mijëvjeçarit të parë Para Krishtit, ndërtimi i piramidave u bë i njohur në Nubia, një zonë që ndodhet në Sudanin e sotëm dhe pjesë të Egjiptit Jugor. Nubianët ndërtuan piramida si për mbretërit ashtu edhe për individët privatë.

Se sa ndërtuan në total nuk është e qartë, por Lehner flet në librin e tij për rreth 180 piramida mbretërore, ndërsa kërkimet e fundit arkeologjike zbulojnë se kishte shumë piramida të tjera të ndërtuara për individë privatë. Sundimtarët e Nubisë vazhduan të ndërtonin piramida deri rreth 1700 vjet më parë. / "Livescience" - Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Barcelona kundër Bayernit kërkon kualifikimin

Barçës i duhen tri pikët kundër Bayernit për ta siguruar kualifikimin si e dyta në grup, por spanjollët mund të kualifikohen edhe me barazim nëse Benfica nuk arrin fitore në ndeshjen ndaj Dynamo Kyivit. “Barcelona është në gjendje të shkojë në Munchen dhe të fitojë atje. Ky është objektivi ynë. Fati ynë është në dorën tonë. Do të shkojmë në një nga stadiumet më të vështira në botë, por duam ta japim maksimumin dhe ta bëjmë lojën tonë”, ka thënë Xavi



tri pikët dhe, në anën tjetër, do ta presë gabimin e Barcelonës. Në grupin F, gjithashtu do të zhvillohet një superndeshje ku Atalanta e pret Villarrealin. Italianëve u duhen tri pikët për ta siguruar kualifikimin, ndërsa spanjollëve u mjafton edhe barazimi. Nga ky grup i pari kualifikohet Manchester Unitedi. Në grupin G të gjitha skuadrat i kanë shanset për kualifikim, kurse përballen Salzburg-Sevilla dhe Wolfsburg-Lille. Në grupin H kualifikimin e kanë siguruar Chelsea dhe Juventus, kurse në Ligën e Evropës pritet të shkojë skuadra e Zenitit.

“Epoka e re”

MUNCHEN, 7 DHJETOR - Barcelona është ende në garë për ta siguruar kualifikimin në fazën tjetër në Ligën e Kampionëve, por për të arritur një gjë të tillë i duhet ta arrijë fitoren në përballje me Bayern Munchenin. “Barcelona është në gjendje të shkojë në Munchen dhe të fitojë atje. Ky është objektivi ynë. Fati ynë është në dorën tonë. Do të shkojmë në një nga stadiumet më të vështira në botë, por duam ta japim maksimumin dhe të bëjmë lojën tonë”, ka thënë Xavi, trajneri i Barcelonës. Skuadrës spanjolle i mjafton edhe barazimi nëse Benfica nuk arrin ta fitojë ndeshjen. Klubi gjerman që drejtohet nga Julian Nagelsmann

tashmë e ka siguruar pozitën e parë në grup ku ka arritur 15 pikë në pesë ndeshje, ashtu siç kanë bërë edhe Ajaxi dhe Liverpooli. Bayerni në këtë ndeshje do të jetë pa Joshua Kimmich, Michael Cuisance, Eric Maxim Choupo-Moting, Bouna Sarr, Marcel Sabitzer, Josip Stanisiq, Leon Goretzka dhe Serge Gnabry. Edhe Barcelona ka mungesa për këtë ndeshje shumë të rëndësishme, kurse ato janë Ansu Fati, Martin Braithwaite, Sergio Aguero, Pedri dhe Sergi Roberto. “Xavi ka pasur mundësinë që të stërvitë për një kohë të gjatë ekipin. Tani mbrojnë më lart se më parë. Kundërsulmi është një armë më e fortë tashmë. Kjo na bën që të jemi më të kujdesshëm dhe të mbulojmë më shumë hapësira. Barcelona ka futbollistë të nivelit botëror. Janë

FORMACIONET E MUNDSHME:

Bayern Munchen: Neuer; Pavard, Sule, Nianzou, Richards; Roca, Tolisso; Sane, Muller, Musiala; Lewandowski.
Barcelona: Ter Stegen; Dest, Araujo, Pique, Alba; Gonzalez, Busquets, De Jong; Dembele, Depay, Coutinho.

nën presion për klasifikimin dhe duhet të fitojnë. Do të japin gjithçka ndaj nesh. Nuk vlen për kualifikimin, por vetëm 3 pikë për ne. E shoh Barcelonën si një nga kandidatet për triumfin final, ndaj do të luajmë më mirë”, ka thënë Julian Nagelsmann, trajner i Bayernit. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi,

Benfica nuk pritet të ketë telashe kundër Dynamo Kyivit ku synon

GRUPI E			GRUPI C		
21:00 Bayern Munchen - Barcelona			21:00 Salzburg - Sevilla		
21:00 Benfica - Dynamo Kyiv			21:00 Wolfsburg - Lille		
Tabela			Tabela		
1. Bayern Munchen	5	15 pikë	1. Lille	5	8 pikë
2. Barcelona	5	7	2. Salzburg	5	7
3. Benfica	5	5	3. Sevilla	5	6
4. Dynamo Kyiv	5	1	4. Wolfsburg	5	5
GRUPI F			GRUPI H		
21:00 Atalanta - Villarreal			18:45 Juventus - Malmo		
21:00 Manchester United - Young Boys			18:45 Zenit - Chelsea		
Tabela			Tabela		
1. Manchester United	5	10 pikë	1. Chelsea	5	12 pikë
2. Villarreal	5	7	2. Juventus	5	12
3. Atalanta	5	6	3. Zenit	5	4
4. Young Boys	5	4	4. Malmo	5	1

Gjyqtarët e Kosovës drejtojnë ndeshjen në Conference League

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Futbollit i Kosovës vazhdon të përparojë. Një lajm i mirë këtë javë erdhi nga UEFA, pasi për herë të parë një katërsheje të gjyqtarëve të Kosovës, në krye me Genc Nuzën i është besuar drejtimi i ndeshjes së Conference League ndërmjet skuadrës qipriote Omonoia FC dhe asaj kazake FC Kairat Almaty, që zhvillohet të enjten në orën 21:00. Asistentët të Nuzës do të jenë Fatlum Berisha dhe Bujar Selimaj, kurse gjyqtar i katërt Visar Kastrati. Kësisoj, Nuza bëhet gjyqtari i parë nga Kosova që do ta drejtojë një ndeshje të këtij niveli në fazën e grupeve në garat e UEFA-s.



Delegimi i gjyqtarëve të Kosovës në Conference League dëshmon punën e mirë që është bërë në futbollin e Kosovës edhe në aspektin e ndarjes së drejtësisë. E për këtë arritje Nuza e ka

falënderuar presidentin e FFK-së, Agim Ademi dhe kryetarin e Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani. “Sot më kujtohen ditët e para si gjyqtar futbollit, atëherë kur presidenti Ademi më ka dhënë kurajë e mbështetje të pazërvë në këtë profesion, prandaj jam krenar që sot në kohën kur unë po bëj hapa të mëdhenj në garat evropiane, ai është duke i prirë me shumë sukses FFK-së. Kjo pa dyshim është një arritje e përbashkët e jona, pas një punë të jashtëzakonshme ndër vite. Falënderoj edhe kryetarin e komisionit të gjyqtarëve, Përparim

Hasani që, po ashtu, na përkrah në vazhdimësi për arritje të mëdha, po ashtu edhe të gjithë ligjëruesit e UEFA-s e FIFA-s që nëpërmjet seminareve të ndryshme na ndihmuan të arrijmë këtu. Premtoj se të gjithë do të vazhdojmë të japim më të mirën tonë për ta çuar në nivele sa më të larta futbollin kosovar”, ka thënë Nuza. Rikujtojmë se ka qenë presidenti Ademi që ka insistuar vazhdimisht në instancat e UEFA-s e të FIFA-s për avancimin e këtyre gjyqtarëve falë edhe performancës së tyre të mirë në ndeshjet e deritashme në garat vendore dhe ato ndërkombëtare.

Prishtina - Drenica, ndeshja kryesore në Kupë

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Në prani të Komisionit të Garave të martën është bërë tërheqja e shortit për rrethin e 1/8 së finales së Kupës së Kosovës në futboll. Fillimisht përfaqësuesit e

klubeve në emër të presidentit Agim Ademi dhe KE të FFK-së i përshëndeti kryetari i KG-së, Abdyl Bellopoja, i cili i njoftoi ata edhe për hollësitë e shortit. Pas tërheqjes së goglave u

përcaktuan edhe çiftet e këtij rrethi, i cili sjell përballje mjaft interesante, ku veçohen ato ndërmjet skuadrave elitare, Prishtina - Drenica, Gjilani - Dukagjini dhe Ballkani - Malisheva.

Çiftet e 1/8-s:

Prishtina - Drenica
Fushë Kosova - Drita Gjilani - Dukagjini
Ulpijana - Arbëria Ferizaj - Llapi
Ballkani - Malisheva
Onix - KEK-u
2 Korriku - Ramiz Sadiku



Arteta: Xhaka është i mrekullueshëm

Londër, 7 dhjetor - Mesfushori Granit Xhaka është rikthyer të luajë për Arsenalin pas lëndimit në gju në ndeshjen kundër Tottenham Hotspurit më 26 shtator, ku iu desh të qëndronte disa muaj larg

fushës së blertë. Lojtari shqiptar e ka kaluar këtë lëndim dhe është rikuperuar 100 % teksa zhvilloi edhe ndeshjen si titullar për Arsenalin kundër Evertonit, ndeshje që u mbyll me humbjen e skuadrës së

Mikel Artetës. Pavarësisht prej rezultatit zhgënjyes në "Goodison Park", trajneri Arteta, i gëzohet faktit të rikthimit të lojtarit shqiptar, teksa është shprehur për faqen e klubit "Arsenal Media". "Kjo është mënyra

se si ai punon dhe është mënyra sesi ai është. Meritat shkojnë për ekipin mjekësor, si dhe për punën që ata kanë bërë dhe është e mrekullueshme që ai të kthehet përsëri", ka thënë Arteta.



Pensionohet Majlinda Kelmendi, nis karrierën si trajnere

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Nën organizimin e Presidencës së Kosovës është mbajtur ceremonia për nderimin e xhudistes Majlinda Kelmendi dhe kalimin e saj nga një sportiste aktive në arenën e sportit të xhudos në trajnere. Në Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, ku u mbajt ceremonia, përveç Vjosa Osmanit, presidente e Kosovës e Majlinda Kelmendit, morën pjesë Hajrulla Çeku, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Agron Kuka, kryetar i Federatës së Xhudos të Kosovës, Driton Kuka, trajner i Kombëtares së Kosovës në Xhudo, Atifete Jahjaga, ish-presidente e Kosovës, Gazmend Muhaxheri, kryetari i komunës së Pejës, familja e Majlinda Kelmendit, kryetarë të partive politike, ambasadorë të akredituar në Kosovë, deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe personalitete të tjera publike dhe sportive.

Me një video mesazh nderimi e falënderimi në ceremoni mori pjesë edhe Marius Vizer, kryetar i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, në pamundësi që të jetë i pranishëm fizikisht në Prishtinë. Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen më të përzemërt për kampionen Majlinda Kelmendi dhe i dha Urdhrin "Shotë Galica", i cili u jepet personave që kanë avokuar apo kanë bërë vepra apo akte guximi.

"Ëndrrën e nisur prej moshës tetë vjeçe, Majlinda e përmbushi duke fituar çdo titull. Ajo nuk u josh që ta vesh uniformën e ndonjë shteti tjetër, por luftoi për ngjyrat e shtetit të Kosovës", theksoi presidentja . Kurse ministri Hajrulla Çeku tha



se kjo është një ngjarje e rëndësishme për të ardhmen e sportit të xhudos në vendin tonë sepse Majlinda po merr një përgjegjësi të re, atë të trajneres përkrah trajnerit të saj që solli shumë suksese ndër vite, Driton Kukës. Ministri, po ashtu, shtoi se Kosova ka arritur suksese të jashtëzakonshme në arenën ndërkombëtare nëpërmjet xhudisteve tona dhe këtë sukses e filloi xhudistja jonë e artë, Majlinda Kelmendi, e cila dëshmoi se me përkushtim dhe punë çdo gjë është e mundur.

"Majlinda Kelmendi me arritjet e saj është shndërruar në ikonën e suksesit kosovar dhe është bërë shembull i shoqërisë sonë, duke i kaluar të gjitha vështirësitë dhe sfidat. Ajo i ka dëshmuar rinisë sonë, se kur punohet me përkushtim dhe qëndrueshmëri, suksesi është i pashmangshëm", u shpreh ministri, duke theksuar se Majlinda po mbyll karrierën e saj si sportiste aktive, por që për sukseset e saj në rrugën e re do të dëgjojmë gjithmonë.

Kryetari i FXHK-së, Agron Kuka,

tha se 20 vjet angazhim, mund, djersë e lëndime, janë kurorëzuar me fitoret dhe sukseset e Majlindës, duke e bërë që të gjithë të na respektojnë dhe nderojnë shtetin dhe simbolet tona edhe ku nuk na kanë pasur dëshirë. Kurse trajneri i Majlindës, Driton Kuka, foli për përvojën dhe ndjenjat që ka kaluar së bashku me Majlindën. "Më krenove mua, krenove familjen, krenove një komb, Majlindë. Kënaqësi kur Majlinda ka pushtuar Rusinë, Brazilin dhe vende të tjera që nuk e kanë pranuar realitetin e quajtur Kosovë. Të jam mirënjohës deri në frymën e fundit Majlindë", u shpreh Driton Kuka.

Ndërsa Majlinda Kelmendi u shpreh se tani e tutje dijen dhe përvojën e saj do ta përcjellë te gjeneratat e reja, pas pensionimit si sportiste aktive. Ajo falënderoi trajnerin dhe ekipin "Një falënderim shumë të madh për vendin tim, për popullin tim, që keni qenë frymëzimi im. Ka qenë nder dhe privilegj shumë i madh për mua ta përfaqësoj Kosovën", ka thënë ajo.

Fitojnë Chicago, Golden State dhe Phoenixi

CHICAGO, 7 DHJETOR - Fitorja e katërt radhazi për Chicago Bulls në NBA. Skuadra e drejtuar nga trajneri Billy Donovan mposhti me rezultatin 109-97 Denver Nuggets duke blinduar vendin e dytë në Konferencën e Lindjes. Një sukses i merituar për Chicagon që edhe pse e pa veten në disavantazhin e 11 pikëve afër fundit të periodes së dytë, arriti të përmbyste gjithçka duke regjistruar suksesin e 17 sezonal, për meritë edhe të të përherëshmit Zac LaVine, autor i 32 pikëve, ndërsa paraqitje të mira për ekipin nga Illinois bëri edhe dyshja Lonzo Ball dhe Nikola Vučević që shënuan nga 20 pikë secili, ndërsa kontribuan edhe me nga 10 rebounde dhe 4 e 2 asistime respektivisht. U rikthye menjëherë



te fitorja Phoenix Suns që kaloi me rezultatin 108-104 San Antonio Spurs. Për skuadrën nga Arizona në këtë sfidë spikatën më shumë Chris Paul me 21 pikë dhe Jamal Crowder me 19 pikë. 2 humbje në 3 ndeshjet e fundit ishin shumë për Golden State Warriorsin që bëri një paraqitje të shkëlqyer ndaj Orlando Magicut duke triumfuar me rezultatin e

thellë 126-95. Stephen Curry ishte sërish më i miri mbi parket për skuadrën nga San Francisco me yllin e Golden States që shkëlqeu me 31 pikë, 3 rebounde e 7 asistime, duke realizuar 7 goditje nga distanca për tri pikë. Për Warriorsin kjo ishte fitorja e 20 sezonale me skuadrën e trajnerit Steve Kerr që ka pësuar katër humbje dhe ndan vendin e parë në Perëndim me Phoenix Suns. Buzëqeshën edhe kampionët në fuqi të Milwaukee Bucksit që mposhtën me rezultatin 112-104 Cleveland Cavaliersin në një sfidë ku greku Giannis Antetokounmpo u shfaq në superformë duke koleksionuar në total 27 pikë, 12 rebounde dhe 2 asistime. Për Bucksin kjo ishte fitorja e 16 në 25 ndeshje.

SHKURT

10 kandidatët kryesorë për trofeun MVP të sezonit të rregullt

Sezoni 2021-2022 në NBA ka përshkruar një pjesë të mirë të rrugëtimit të tij, duke zbuluar skuadrat dhe basketbollistët më të mirë. Mjaft e fortë duket gara për trofeun MVP të sezonit të rregullt, ku janë të shumtë kandidatët për këtë çmim të rëndësishëm. Sipas mediave amerikane, në krye të listës ndodhet Stephen Curry, që po zhvillon një sezon shumë të mirë. Kandidatët për trofeun MVP: Stephen Curry (Golden State), Kevin Durant (Brooklyn), Giannis Antetokounmpo (Milwaukee), Nikola Jokiq (Denver), Chris Paul (Phoenix), Jimmy Butler (Miami), DeMar DeRozan (Chicago), Zach LaVine (Chicago), Trae Young (Atlanta), Rudy Gobert (Utah Jazz).

Covidi 'pushton' Tottenhamin

Tottenhami është goditur nga koronavirusi para ndeshjes të së enjtes në Konferencë Ligë ndaj Rennes. Gjashtë futbollistë të ekipit të parë dhe dy anëtarë të stafit besohet se kanë dalë pozitivë me koronavirus, raporton "Sky Sports". Ky "shpërthim" i koronavirusit mund të ketë ndikim të keq te Tottenhami në ndeshjet pasuese. Pasi do të përballet me Rennesin, ekipi i Antonio Contes do të rikthehet në Premierligë ku do të udhëtojë për t'u përballur me Brightonin të dielën, para se të përballet me Leicesterin të enjten dhe më pas ta presë Liverpoolin më 19 dhjetor.

Lewandowski: Do të doja që Messi të ishte i sinqertë për 'Topin e Artë'

Robert Lewandowski u renditi i dyti në garën për "Topin e Artë 2021", me Leo Messin duke e fituar atë çmim. Sulmuesi polak e ka zbuluar zhgënjimin që nuk doli i pari. Lewandowski ndërkohë e fitoi çmimin e sulmuesit më të mirë të vitit. "Jam i zhgënjyer, s'mund ta mohoj. Nuk mund të them se isha i lumtur. E kam një ndjenjë zhgënjimi. Të jesh kaq afër, të garoj me Messin, natyrisht e respektoj se si luan dhe çfarë ka arritur. Thjesht, fakti që arrita të garoj me të, tregon nivelin që isha në gjendje ta arrija", ka deklaruar Lewandowski. "Nuk jam entuziast për ta marrë çmimin për vitin 2020. Dua që ajo (deklarata e Messit për 'Topin e Artë 2020') të ishte e sinqertë nga një lojtar i madh dhe jo vetëm fjalë boshe", ka shtuar Lewandowski

Felixi, afër largimit nga Atletico

Sulmuesi Joao Felix mund të largohet nga Atletico Madridi. Ylli portugez është i pakënaqur me situatën aktuale të 'Rojiblancos'. Diario AS raporton se nëse Atletico dështon të kualifikohet më tutje në Ligën e Kampionëve, Felix mund ta kërkojë largimin. Ai ka kontratë me Atletico Madridin deri në vitin 2019 për rreth 120 milionë euro dhe ai bëri shumë mirë këtë sezon. Pavarësisht prej paraqitjeve të mira individuale, arritjet me grupin duket se nuk janë të kënaqshme mjaftueshëm për portugezin.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Precednika /Office of the Mayor

DATE/A:	07.12.2021
REFERENC-Ë:	
PËR/ZATO:	Publikun
NGA/OD/FROM:	Kryetari i Komunës Fadil NURA
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Njoftim për Takim me Publikun

Duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.1 dhe 68.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, konform nenit 67 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr. 01-110-385 të datës 03.12.2008, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 03/2020, për Transparencë në Komuna, dhe konform nenit 6 të Rregullores për Transparencë në Komunën e Skenderajt, Kryetari i Komunës së Skenderajt mbanë takimin e dytë me Publikun me qëllim të informimit të pjesëmarrësve për aktivitetet e Komunës.

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Skenderajt, së takimi me publikun do të mbahet më datën **21.12.2021 (e Marte), në orën 14.00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Skenderajt.**

Në këtë takim përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e Komunës, kurse qytetarët mund të shprehin pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.

Mbajtja e këtij takimi do të bëhet konform masave mbrojtëse të parapara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Ju inkurajojmë që të merrni pjesë në këtë takim, dhe kështu të bëheni pjesë e zhvillimit të jetës dhe politikës komunale.

Me respekt!

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "REAL ÇELIK" SH.P.K me seli Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit 811386219 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30-ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještamo sve klijente da Tvrtka "REAL ÇELIK" DOO u Prizren doneo odluku da ugasi biznis po br. Regjistra 811386219 i ujedno imenovao Likfidatora o sprovođenju postuaka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novice.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "REAL ÇELIK" LLC in Prizren has come to the decision to quit its business with registry 811386219. The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day to newspaper announcement publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Shkurta Gjonbalic, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme SH.M.E.J "Hivzi Sylejmani" në Fushë Kosovë.

► "Beki Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810164848.

► Dhurata Selimi shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Fakultetit Filologjik në UP, dega Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.

► Petrit Këpuska Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH. M të Veterinarisë "Hysni Zajmi".

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ABC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embalatadora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fábrica de Bebidas Gasosas Salvadoreñas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fuzli Sijak, Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Fuzada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Ibi Zotal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Pariza Sales soken Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales





MEKA

HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues